



**Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly**

LEGJISLATURA V

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Mbledhja nr. 42

Prishtinë, më 19.4.2016 në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-303

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Jasmina Zhivkoviç, Agim Çeku, Mufera Shinik, Agim Kikaj, Milka Vuletiq, Sasha Milosavleviç, Slavko Simiq, Qerim Bajrami, Veton Berisha dhe Danush Ademi.

Munguan: Fisnik Ismaili dhe Rustem Berisha,

Pjesëmarrës të tjerë: përfaqësues nga OSBE-ja Andrea Najvirtova, Senad Karaahmetoviç; përfaqësuese nga KDI-a Mërgime Kajtazi; përfaqësues nga NVO Aktivë; përfaqësues nga PAI; përfaqësues i Qendrës Humanitare në Mitrovicë, konsultant i Sekretariatit të KKK Zijush Ahmeti; si dhe Drejtorja për Media dhe Marrëdhënie me Publikun Celal Iliaz,.

Stafi mbështetës i Komisionit: Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: **Jasmina Zhivkoviç**, kryesuese e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të Komisionit, dt. 22.3.2016, 24.3.2016 dhe 30.3.2016;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-067 për statusin dhe të drejtat e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë, me amendamente të Komisionit Funksional për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione;**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-061 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës, me amendamente të Komisionit Funksional për Punë të Jashtme;**
- 5. Të ndryshme.**

- 1. Miratimi i rendit të ditës**

Kryesuesja konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

- 2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të Komisionit, dt. 22.3.2016, 24.3.2016 dhe 30.3.2016**

Kryesuesja konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura, më 22.3.2016, 24.3.2016 dhe 30.3.2016, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-067 për statusin dhe të drejtat e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë, me amendamente të Komisionit FunkSIONAL për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione

Kryesuesja paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr. 05/L-067 për statusin dhe të drejtat e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë dhe kërkoi nga anëtarët e Komisionit, që të deklarohen nëse ka ndonjë propozim në amendamente, në mënyrë që vërejtjet të përfshihen në rekomandim.

Pas diskutimeve në Projektligj dhe pas shqyrtimit të raportit me amendamente të Komisionit FunkSIONAL, Komisioni nxori këtë:

Rekomandim

- I. Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, shqyrtoi Projektligjin nr. 05/L-067 për statusin dhe të drejtat e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-061 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës, me amendamente të Komisionit FunkSIONAL për Punë të Jashtme

Kryesuesja paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr.05/L-061 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës, me raport- amendamente të Komisionit FunkSIONAL dhe vlerësoi se nuk ka vërejtje apo sugjerime nga anëtarët e Komisionit.

Meqë nuk kishte vërejtje në projektligj, dhe pas shqyrtimit të raportit me amendament të Komisionit FunkSIONAL, Komisioni nxori këtë:

Rekomandim

- I. Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, ka shqyrtuar Projektligjin nr.05/L-061 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhje plenare të Kuvendit.

5. Të ndryshme

Kryesuesja ngrii dy çështje. E para, e informoi Komisionin se është marrë përgjigjja zyrtare nga partneriteti i OSBE-së, që vizita studimore në Kuvendin e Republikës së Kroacisë, do të realizohet më 16 dhe 17 maj 2016, kurse nisja do të bëhet më 15 maj, ndërsa kthimi më 18 maj 2016. Njëherazi, ngarkohet administrata për mbështetje të Komisionit, që në bashkëpunim me Drejtorinë për Protokoll dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare, të kryejë aktivitetet e nevojshme rreth udhëtimit dhe përgatitjen e vizave të grupit të dytë të delegacionit.

Senad Karaahmetović, theksoi se OSBE-ja financon të gjitha shpenzimet e udhëtimit të delegacionit, për 8 anëtarë të Komisionit, ndërsa për anëtarët tjerë dhe administratën, mbetet të financohet nga buxheti i Komisionit.

Kryesuesja, veçoi se Komisioni është në procedurë të monitorimit të Ligjit për Shërbimin Civil, gjegjësisht neni 11, dhe se GP ka kryer punën në disa faza. Në këtë periudhë, Komisioni ka caktuar ekspert nga Instituti Demokratik i Kosovës KDI-së, me qëllim të gjetjes së të dhënave konkrete në terren, përfaqësimi i komuniteteve në institucionet qendrore dhe lokale. Pas marrjes së raportit nga KDI, Komisioni bën shqyrtimin e të njëjtit dhe nxjerr rekomandime.

Lidhur me këtë çështje, interesim për mbështetje kanë paraqitur edhe Misioni i OSBE-së, ndërsa për detjaje të mëtejme fjalën ia dha përfaqësueses, Andrea Najvirtova.

Andrea Najvirtova, këshilltare e lartë politike për komunitete në kuadër të Misionit të OSBE-së, theksoi se që nga viti 2013, OSBE-ja ka dalë me raport lidhur me punësimin e pjesëtarëve të komuniteteve jo-shumicë dhe përfaqësimi i tyre në institucionet qendrore dhe lokale. Mendon se në bazë të raportit, situata nuk paraqet rezultate të kënaqshme, ngase institucionet nuk kanë marrë hapa të duhur për përfaqësimin e komunitetit pakicë.

Ne kemi njohuri se Komisioni për Komunitete është në procedurë të monitorimit të Ligjit për Shërbimin Civil, konkretisht neni 11, me ç' rast ka angazhuar ekspert nga KDI-a.

Shprehu qëndrimin e saj se OSBE-ja është e interesuar të marrë pjesë në takime të përbashkëta ku do të ndihmoj me planet e përcaktuara për arritjen e përfaqësimit të komuniteteve në institucionet publike.

OSBE-ja, planifikon të publikojë një raport të ri në muajin shtator, me përmbajtje se cilat masa janë zbatuar nga institucionet apo eventualisht ndonjë komunë, si dhe çështja e punësimit për pjesëtarët e komunitetit pakicë.

Kryesuesja, falënderoi OSBE-në, për përkrahje dhe mbështetje të Komisionit, për nga aspekti i përfaqësimit të komuniteteve, si në nivel qendror ashtu dhe atë lokal.

Theksoi se të gjitha ligjet janë të hartuar mirë, por problemet paraqiten gjatë zbatueshmërisë të tyre në praktikë. Në kuadër të strategjisë legjislative të Qeverisë, në muajin shtator të vitit 2016, do të procedohet ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Ajo konstatoi se qëllimi kryesor i Komisionit është që para se të procedohet ky projektligj, të bëhen vlerësimet e të gjitha aktiviteteve, më pas do të hartojë raportin me rekomandime dhe i njëjti do të procedohet për miratim në Kuvend.

Veton Berisha, përkrah idenë për mbështetje të Misionit të OSBE-së, mirëpo fillimisht duhet bërë pyetje sa do jetë efektive nëse në të njëjtën kohë dalim me dy raporte. Sa i përket raportit të OSBE-së për periudhën 2013 e deri më sot, nuk ka pasur lëvizje pozitive në përfaqësimin e komuniteteve.

Në bazë të ligjit aktual, janë bërë keqpërdorime, nga se shumë qytetarë janë punësuar në emër të komuniteteve tjera. Në bazë të disa kriterëve, shihet se mungon iniciativa e interpretimit ligjor për përfaqësimin e komuniteteve në institucionet publike.

Në vijim, shtoi se GP ka angazhuar një ekspert nga organizata e KDI-së, me qëllim që të shqyrtohen dhe analizohen dispozitat ligjore të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, konkretisht nenin 11. Ishte i mendimit se në muajin prill, KDI-ja do të dorëzojë raportin me rekomandime, dhe bashkërisht do të analizojmë gjetjet në terren lidhur me përfaqësimin e komuniteteve në institucionet qendrore dhe ato lokale.

Më pas, Komisioni do të hartojë raportin përfundimtar, i cili do të procedohet për miratim në Kuvend.

Qerim Bajrami, përshëndet mbështetjen e organizatës së KDI-së si dhe përkrahjen nga OSBES-a, lidhur me monitorimin e Ligjit për Shërbimin Civil, konkretisht neni 11.

Theksoi se ekziston lista e të punësuarve, në emër të komunitetit boshnjak, rom, ashkali, dhe ky fakt paraqet mos përputhje në krahasim me 10 % e përfaqësimit të komuniteteve. Sipas mendimit të tij, duhet të verifikohen emrat e personave që punojnë në institucione publike, në të kundërtën, situata aktuale paraqet shkelje të të drejtave të komunitetit pakicë.

Konsideron se gjatë harimit të raportit final, Komisioni do të nxjerrë rekomandime lidhur me mos përfaqësimin e drejtë të komuniteteve, bazuara në nenin 11, të Ligjit për Shërbimin Civil .

Mbledhja përfundoi në orën 14:00.

E përgatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Jasmina Zhivković